



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
MINISTRI

Nr. 15233 prot.

Data: 23, 1, 2025

VENDIM

Nr. 19, Datë 23, 1, 2025

PËR

VLERËSIMIN NË KUADËR TË HEQJES SË AKREDITIMIT ME KUSHT PËR
OFRUESIN PUBLIK TË AFP-SË, SHKOLLA E MESME
TEKNOLOGJIKE "HYSEN ÇELA" Durrës

Bazuar në pikën 2, të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017. "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Urdhrin nr. 128, datë 06.07.2021, "Për miratimin e Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional", si dhe raportit të monitorimit të posaçëm për Skollën e Mesme Profesionale, Teknologjike "Hysen Çela" Durrës, dërguar nga AKAPPK me shkresën nr. 362/11prot.. datë 02.12.2024.

VENDOSI:

1. Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla e Mesme Teknologjike "Hysen Çela", Durrës, i ka plotësuar kushtet e vendosura në Vendimin nr. 6571, datë 21.05.2024, të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, "Akreditim me kusht" me afat vlefshmërie deri më 20.11.2024.

2. Bazuar në Raportin e Monitorimit të Posaçëm dhe Urdhrin e miratimit të tij nr. 46 datë 02.12.2024, i jepet vlerësimi përfundimtar pozitiv "Akreditim i plotë" dhe heqjen e kushteve të akreditimit për kualifikimet profesionale si më poshtë vijon:

- "Teknologji Ushqimore", Niveli II në KSHK, A-II-21;
- "Teknologji e Përpunimit të Brumërave", Niveli III në KSHK, A1-III-22;
- "Teknologji Ushqimore", Niveli IV në KSHK, A-IV-18;

- d) "Detari", Niveli II në KSHK, J-II-20;
- e) "Peshkim", Niveli III në KSHK, J1-III-21;
- f) "Detari", Niveli IV në KSHK, J-IV-17;
- g) "Tekstil – Konfeksione", Niveli II në KSHK, D-II-17;
- h) "Rrobaqepësi", Niveli III në KSHK, D1-III-19;
- i) "Tekstil – Konfeksione", Niveli IV në KSHK, D-IV-19;
- j) "Ekonomi Biznes", Niveli II në KSHK, L-II-21;
- k) "Llogari", Niveli IV në KSHK, L4-IV-19;

3. Afati përfundimtar i "Akreditimit të plotë" është 4 vite, duke filluar nga data e firmosjes së këtij vendimi.

4. Bazuar në pikën 1/a të nenit 18 të Urdhrit nr.128 datë 6.7.2021 "Për miratimin e Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional", ofruesi publik i AFP-së, Shkolla e Mesme Teknologjike, "Hysen Çela", Durrës, do t'i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm çdo 4 vjet periodikisht, në kuadër të procesit të akreditimit institucional.

5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit të plotë, brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e vazhdueshëm, për të garantuar qëndrueshmërinë e përmirësimeve të reflektuara në kuadër të plotësisht të kritereve dhe veçanërisht ato që lidhen me zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të akreditimit.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

